

Kalendari Kombëtar i Promocionit të Shëndetit liston ditët kushtuar çështjeve shëndetësore, javët dhe muajt që janë shpallur dhe njohur nga organizata shëndetësore si dhe që njihen nga komuniteti i profesionistëve shëndetësorë. Në këtë kalendar janë listuar ditë/javë/muaj të përcaktuara për promovimin e çështjeve të ndryshme shëndetësore në Shqipëri ose ndërkombëtarisht.

Kalendari i Promocionit të Shëndetit orienton, prej disa vitesh tashmë, punën e gjithë punonjësve të edukimit dhe promocionit shëndetësor në Shqipëri. Për çdo ditë/javë/muaj të kalendarit planifikohen aktivitete të ndryshme me karakter ndërgjegjësues, advokues dhe parandalues, me synimin kryesor përmirësimin e shëndetit të komunitetit.

Risia e këtij viti është plotësimi i variantit elektronik të këtij kalendarit me materiale më të plota informuese për secilën ditë. Në këtë mënyrë, kalendarit shërben edhe si një mjet informimi dhe edukimi për të gjithë popullatën, pasi përmban informacion te detajuar për çdo ditë/javë të shëndetit. Në të, çdokush mund të marrë informacion për problemet kryesore shëndetësore, mjafton që të klikojë në ditën përkatëse. Me afrimin e secilës datë, informacioni rreth saj do të përditësohet dhe me aktivitete promovuese të planifikuara për t'u zhvilluar në të gjithë vendin.

Ftohen të gjithë punonjësit e edukimit dhe promocionit shëndetësor në rrethe që duan të dërgojnë informacion mbi evente me karakter ndërgjegjësues për ditët e shëndetit, ti dërgojnë ato në adresën: AMJ@ishp.gov.al. Vendimi për vendosjen ose jo të materialit në website-in e ISHP-së do të merret nga specialistët e Departamentit të Edukimit dhe Promocionit Shëndetësor pranë ISHP-së.